

20 tetor 2011, Prizren

REAGIM

...i OJQ-ve në Prizren në lidhje me debatin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me shoqërinë civile të Prizrenit për Projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit

Ne, organizatat e poshtënëshkruara të shoqërisë civile nga Prizreni shprehim pakënaqësinë tonë në lidhje me praktikën jodemokratike dhe diskriminuese të qeverisjes në Kosovë. Konkretisht, jemi të shqetësuar për mënyrën se si po tentohet të miratohet projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit. Në një debat me shoqërinë civile, të organizuar sot në Prizren, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe OJQ Urbaniak, është tentuar që në mënyrë klandestine të improvizohet procesi i konsultimeve publike për këtë projekt-ligj. Prandaj, shoqëria civile dhe komuniteti i Prizrenit për të shprehur pakënaqësinë dhe protestën e vet me këto praktika, sot ka lëshuar sallën e debatit menjëherë pas nisjes së tij, duke i artikuluar këto pakënaqësi:

- Projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit aktualisht ndodhet në Kuvendin e Kosovës duke iu nënshtruar shqyrtimit parlamentar, prandaj Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka të drejtë të organizojë konsultime publike dhe të modifikojë përmbajtjen e projekt-ligjit.
- Përmbajtja aktuale e projekt-ligjit është refuzuar kohë më parë nga Kuvendi i Kosovës në seancë plenare para një muaji, Komisioni parlamentar për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor dy herë rradhazi ka marrë vendim unanim për të refuzuar dhe kthyer projekt-ligjin në qeveri, Komisioni parlamentar për të drejtat e njeriut, para disa ditësh e ka refuzuar projekt-ligjin, Kuvendi Komunal i Prizrenit është deklaruar kundër shumë elementeve që i përmban projekt-ligji aktual, shoqëria civile e Prizrenit tashmë disa muaj i ka artikuluar vërejtjet dhe rekomandimet e veta për përmbajtjen e projekt-ligjit. Edhe përkundër të gjitha refuzimeve, MMPH vazhdon të insistojë dhe të promovojë të njëjtën përmbajtje të projekt-ligjit.
- Debatin e sotëm e vlerësojmë vetëm një formalitet të MMPH, të cilin ata do të përpiqen të na proklamojnë si konsultim publik me komunitetin për projekt-ligjin. Konsultimet publike për këtë projekt-ligj do të duhej të mbaheshin prej vitit 2009 kur ka filluar hartimi i tij. Ndërsa sot, derisa projekt-ligji është në shqyrtim parlamentar, Ministria po përpiqet që këtë të metë ta kompensojë në mënyrë klandestine
- Edhe nëse këtë debat e konsiderojmë si konsultim të rregullt publik për projekt-ligjin, prapsepërpë, me mënyrën se si po zhvillohet, po shkelet Rregullorja e Punës e Qeverisë, konkretisht në Nenin 32, i cili kërkon që:
 - a. Sponsorizuesi duhet të ofrojë informata të mjaftueshme në një formë të kuptueshme nga publiku për t'i mundësuar publikut që të kuptojë natyrën dhe pasojat e propozimit
 - b. Të shpallet publikimisht fillimi i procesit të konsultimit dhe të ofrohet kohë e mjaftueshme për publikun dhe OJQ-të që të involvohen në këtë proces
 - c. Asnjëra nga këto obligime ligjore nuk po respektohen.
- Konsultimet publike në Prizren, për Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit do të duhej t'i organizonte shoqëria civile e Prizrenit dhe jo një OJQ anonime nga Prishtina. Në debatin e sotëm janë ftuar më shumë OJQ nga Prishtina se Prizreni, nuk janë ftuar grupet e komunitetit nga Prizreni, në total, në mesin e të ftuarve ka më shumë institucione shtetërore (qendrore dhe lokale) se sa komunitete, dhe mbi të gjitha, nuk mjaftojnë një, dy ose tre takime ose debate të ngushta dhe të shkurtra, pasi që po flitet për një ligj për qytetin

- Prezenca e Z. Faith sot në debat është edhe një dëshmi se miratimi i këtij ligji është shndërruar në agjendë personale të tij. ICO është duke ushtruar presion të hatashëm tek institucionet shtetërore të Kosovës për ta miratuar sa më parë këtë projekt-ligj. Kjo e bën Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit një prioritet të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, duke i anashkaluar totalisht interesat e komunitetit në Prizren
- Prizreni nuk është kundër nevojës për të patur një ligj për Qendrën Historike të qytetit, por ne dëshirojmë të kemi një ligj të mirë që do të funksionalizojë qytetin dhe që do të fusë sistemin e menaxhimit urban në qendrën historike të qytetit. Gjithashtu, ne si komunitet dëshirojmë të përfshihemi në procesin e hartimit të një ligji për qytetin nga fillimi deri në fund. Ne jemi kundër praktikave përjashtuese të qeverisë ndaj komunitetit kur bëhet fjalë për ligje shumë ndieshme, si ai për Qendrën Historike të Prizrenit
- Përmbajtësisht, ne nuk pajtohemi me tekstin aktual të projekt-ligjit pasi që ai: parasheh transferim të autoritetit publik tek autoritetet fetare, Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë i jep kompetenca politike dhe ligjore më shumë se sa që ajo ka në Serbi, nuk i merr për bazë politikën dhe dokumentet ekzistuese të KK Prizren, si psh. Plani i Konservimit, nuk parasheh kurrfarë sistemi të menaxhimit publik për qendrën historike, parasheh krijimin e një strukture jofunksionale institucionesh që do të menaxhojnë qendrën historike, nuk krijon parakushte për zhvillimin ekonomik të qytetit bazuar në resurse të trashëgimisë kulturore. Për më tepër, projekt-ligji krijon pengesa që do të ngufasin potencialin kulturor dhe të trashëgimisë kulturore, imponon shumë ndalesa, sanksione, burrokraci, por nuk parasheh kompensime, dhe ke një mori defektesh tjera.
- OJQ-të e Prizrenit e kanë dorëzuar një Peticion për projekt-ligjin për QHPz në Kuvend, ku mbi 10.000 qytetarë e kanë shprehur vullnetin e tyre kundër përmbajtjes aktuale të projekt-ligjit. Edhe pse ky vullnet është shprehur në formë të organizuar dhe kolektive, Ministria asnjëherë nuk ka hyrë në dialog me OJQ-të që e kanë sponsorizuar Peticionin, duke e injoruar totalisht ekzistencën e Peticionit.
- Prandaj, ne organizatat sponsorizuese të Peticionit, kemi marrë përsipër obligimin e përfaqësimit ligjor të kërkesave të këtyre qytetarëve dhe nuk mund të shkelim këtë vullnet duke u bërë pjesë e një procesi të parregullt të konsultime që Ministria po tenton të realizojë në mënyrë jo-ligjore, klandestine dhe sa për sy e faqe.

Organizatrat e nënshkruara:

EC Ma Ndryshe,

Fondacioni për Trashëgimi Kulturore,

Forumi për Trashëgimi Kulturore,

Academy for Training and Technical Assistance,

N'GO,

Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren,

X40 dhe

EUIRC